


FËMIJË DHE GRA

ÇKA THONË NUMRAT



KONSTATIME KYÇE NGA STUDIMI ME TREGUES TË SHUMËFISHTË TË GRUMBULLUAR-2011


Studimi me tregues të shumëfishtë të grumbulluar (MICS) është program ndërkombëtar për hulumtim të amvisërive, i përgatitur dhe i mbështetur nga UNICEF-i. Përmes këtij studimi fitohen informacionet më të reja në lidhje me gjendjen e fëmijëve dhe grave, që ndihmojnë më lehtë të ndiqet përparimi në përmbushjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Mijëvjeçarit dhe të detyrimeve tjera të miratuara ndërkombëtare. Hulumtimi përfshin një mostër reprezentative në nivel nacional të amvisërive, grave dhe fëmijëve. Në vendin tonë, përveç hulumtimit të mostrës reprezentative nacionale, është bërë hulumtimi i mostrës reprezentative në vendbanimet rome. Këta konstatime bëjnë me dije për gjendjen e të drejtave të ndryshme të fëmijëve. Konstatimet e mostrës reprezentative nacionale janë shënjuar me ngjyrë të kaltër, ndërsa atë të mostrës rome janë shënjuar me ngjyrë të gjelbër.

PËRSHKRIMI: ■ Mostra nacionale ■ Vendbanimet rome


Karakteristikat e amvisërive

NDARJA E ANËTARËVE TË AMVISËRIVE NË BAZË TË MOSHËS DHE GJINISË

MOSTRA NACIONALE



VENDBANIMET ROME



Fëmijë meshkuj(0-17)



Fëmijë femra (0-17)




Meshkuj (+18)



Femra (+18)



FËMIJË NËN MOSHËN PESËVJEÇARE, TË CILËT JETOJNË ME TË DY PRINDËRIT




PËRSHKRIMI: ■ Mostra nazionale ■ Vendbanimet rome

E drejta e shëndetit dhe e të ushqyerit

MËNYRA E PLANIFIKIMIT TË FAMILJES NGA GRATË E MARTUARA OSE ATO QË JANË BASHKËJETESË


Numrat vërtetojnë se përqindja e grave, të cilat janë të informuara për kontracepsionin është shumë e lartë. Megjithatë pothuajse çdo e pesta grua, që dëshiron ta prolongojë shtatzëninë ose dëshiron ta ndërpresë lindjen e fëmijëve për momentin nuk përdorë kontracepsion.



SHËNDETI I NËNAVE DHE FËMIJËVE



FEMRA TË REJA TË MOSHËS 15-19 VJEÇARE, TË CILAT KANË LINDUR OSE PËR MOMENTIN JANË SHTATZËNA

Numrat bëjnë me dije se përfaqësimi i grave të reja nga mosha 15 deri në moshën 19 vjeçare, të cilat kanë lindur fëmijë ose për momentin janë shtatzëna është i vogël në mostrën nacionale. Mirëpo pothuajse çdo e pesta femër rome e moshës 15-19 vjeçare ka lindur fëmijë ose është shtatzënë.




FËMIJA I FUNDIT I LINDUR NË DY VITET E FUNDIT ME OPERIM CEZARIAN

Mënyra e lindjes së foshnjës mund ta rrezikojë shëndetin e nënave dhe foshnjave. OBSH-ja thekson se përqindja e grave, të cilat lindin me operim cezarian nuk duhet të jetë më shumë se 15%. Numri i fëmijëve, që lindin me operim cezarian shënon rritje në proporcion me arsimin e nënave.



GRATË, TË CILAT E VIZITOJNË MJEKUN SË PAKU 4 HERË GJATË SHTATZËNISË


UNICEF-i dhe OBSH-ja (Organizata Botërore e Shëndetësisë) rekomandojnë së paku katër kontrolime para lindjes, me qëllim që të mbrohet shëndeti dhe mirëqenia e nënës dhe foshnjës. Numrat vërtetojnë se gratë e komunitetit romë dhe gratë shqiptare më rrallë e vizitojnë mjekun, në krahasim me gratë maqedonase.




PËRSHKRIMI: ■ Mostra nacionale ■ Vendbanimet rome

E drejta e shëndetit dhe e të ushqyerit

FEMRA TË REJA TË MOSHËS 15-19 VJEÇARE, TË CILAT RREGULLISHT E KONSUMOJNË DUHANIN



Duhani njihet si faktor i rrezikshëm i shumë sëmundjeve vdekjeprurëse. Numrat tregojnë se femrat e reja të vendbanimeve rome pinë duhan dy herë më shumë sesa ato të mostrës nacionale. Çdo e pesta femër rome e moshës 15-19 vjeçare është duhanpirëse.



FEMRA TË REJA TË MOSHËS 15-19 VJEÇARE, TË CILAT RREGULLISHT E KONSUMOJNË ALKOOL

Po ashtu, përdorimi jo i matur i alkoolit e zmadhon rrezikun e probleme shëndetësore. Për dallim nga rasti i pirjes së duhanit, tani numrat vërtetojnë se femrat e reja të vendbanimeve rome konsumojnë më pak alkool, në krahasim me ato të mostrës nacionale.

FEMRAT E MOSHËS 15-49, TË CILAT RREGULLISHT PINË DUHAN

Numrat bëjnë me dije se proporcioni i grave duhanpirëse rritet në raport me moshën. Nëse shikohet grupmosha më e gjerë 15-49, do të shihet se 30 për qind të femrave kanë deklaruar se rregullisht pinë duhan. Numrat po ashtu vërtetojnë se përqindja e femrave duhanpirëse të mostrës nacionale shënon rritje në proporcion me pasurinë e familjes. Në vendbanimet rome hasen shifra të kundërta, pirja e duhanit zvogëlohet aty ku shënohet rritjen të pasurisë së familjeve.



FEMRAT E MOSHËS 15-49, TË CILAT RREGULLISHT KONSUMOJNË ALKOOL




Numrat bëjnë me dije se konsumimi i alkoolit në njëfarë mënyre varet nga pasuria e familjes. Në nivel të mostrës nacionale pesë herë është më i madh probabiliteti, që gratë e kategorisë më të pasur të konsumojnë alkool sesa ato të kategorisë më të varfër.

GRATË QË PINË DUHAN GJATË SHTATZËNISË



Përhapja e pirjes së duhanit, në veçanti gjatë shtatzënisë paraqet problem të rëndësishëm shëndetësor. Numrat vërtetojnë se çdo grua e katërt pi duhan gjatë shtatzënisë.




PËRSHKRIMI: ■ Mostra nazionale ■ Vendbanimet rome

FËMIJËT E LINDUR NËNPESHË (TË RRËGJUAR)




Lindja nënpeshë (më pak se 2,500 gramë) bart rreziqe shumë serioze ndaj shëndetit të fëmijës. Fëmijët, të cilët nuk janë ushqyer sa duhet në mitër ballafaqohen me rritje të rrezikut të vdekshmërisë gjatë muajve të parë të jetës. Numrat vërtetojnë se probabiliteti i lindjes së fëmijës nën 2,500 gramë në vendbanimet rome është dy herë më i madhe sesa niveli i mostrës nacionale.

PËRQINDJA E LINDJEVE NËN 2,500 GRAMË



FËMIJËT, TË CILËT I KANË PRANUAR TË GJITHA VAKSINAT E NEVOJSHME

Numrat vërtetojnë se mbi 90% të fëmijëve i kanë pranuar të gjitha vaksinat e rekomanduara. Probabilitet, që fëmijët e vendbanimeve rome do t'i marrin të gjitha vaksinat është më i ulët në krahasim me fëmijët e mostrës nacionale.




TË USHQYERIT

FËMIJËT QË KANË PIRË GJI (MËKUAR)

NË ORËN E PARË TË LINDJES

21%



VETËM NGA GJIRI I NËNËS NË GJASHTË MUAJT E PARË TË JETËS

23%




Mëkimi i mbron fëmijët nga infeksionet, siguron burim ideal të përbërjeve ushqyese, është ekonomik dhe i sigurt. Megjithatë, shumë nëna, mjaft herët e ndërpresin mëkimin e foshnjave të tyre dhe më së shpeshti kjo bëhet nga presioni për të kaluar në ushqime tjera, që do ta zëvendësojnë qumështin e nënës. UNICEF-i dhe OBSH-ja rekomandojnë që mëkimi të fillojë në orën e parë të lindjes dhe foshnjës t'i jepet vetëm qumësht të gjirit të nënës (pa lëngje dhe ushqime tjera) në gjashtë muajt e parë. Numrat vërtetojnë se edhe përkundër faktit se 90 për qind të fëmijëve të lindur në dy vitet e fundit kanë qenë të mëkuar për një periudhë të caktuar, megjithatë është i vogël numri i fëmijëve, që kanë qenë të mëkuar në orën e parë të lindjes, gjegjësisht deri në muajin e gjashtë të jetës kanë pirë vetëm nga gjiri i nënës.

5%
Mostra nacionale



17%
Vendbanime rome



FËMIJËT NËN MOSHËN PESËVJEÇARE, TË CILËT JANË SHUMË TË ULËT PËR MOSHËN E TYRE

Kur fëmijët janë tepër të shkurtër për moshën e tyre, kjo nënkupton shenjë të vuajtjes kronike nga të ushqyerit e dobët, të shkaktuar nga ushqimi i pamjaftueshëm ose joadekuat. Numrat vërtetojnë se nuk është i madh përfaqësimi i fëmijëve të ushqyer dobët në mostrën nacionale. Nga ana tjetër në vendbanimet rome haset përqindje e madhe e fëmijëve, të cilët konsiderohen se janë tepër të shkurtër për moshën që kanë.


PËRSHKRIMI: ■ Mostra nacionale ■ Vendbanimet rome

E drejta e arsimit inkluziv (përfshirës) dhe cilësor


ZHVILLIMI I HERSHËM I FËMIJËVE

FËMIJËT E MOSHËS 36-59 MUAJSH, TË CILËT VIZITOJNË PROGRAME PËR ZHVILLIM TË HERSHËM TË FËMIJËVE

Në vend sigurohen programe për zhvillim të hershëm të fëmijëve në kuadër të programeve të kopshteve për fëmijë, të cilat i financon shteti dhe përmes një numri të vogël të qendrave për zhvillim të hershëm të fëmijëve. Meqenëse para së gjithash shërbime të këttilla ofrohen në qytete, fëmijët, të cilëve më së shumti iu nevojiten shërbime të këttilla, nuk kanë qasje në to.



FËMIJËT E MOSHËS 36-59 MUAJSH, TË CILËT NË SHTËPI KANË MË SHUMË SE TRE LIBRA PËR FËMIJË




Fëmija i rritur në ambiente me më shumë libra ka mundësi, që më mirë të njohet me botën e fjalës së shkruar. Përveç kësaj hulumtimet vërtetojnë se fëmijët, të cilat janë rritur në shtëpi me libra, kanë më shumë mundësi të arrijnë sukses në shkollë. Numrat tregojnë se çdo i dyti fëmijë nuk ka më shumë se tre libra dhe se fëmijët në vendbanimet rome, fëmijët që jetojnë në fshat dhe fëmijët shqiptar kanë më pak mundësi të kenë qasje në libra në raport me mostrën nacionale.

PËRSHKRIMI: ■ Mostra nacionale ■ Vendbanimet rome




FËMIJËT E MOSHËS 36-59 MUAJSH, TË CILËT KANË ZHVILLIM TË DREJTË NË RAPORT ME KATËR SFERAT E ZHVILLIMIT

Përvetësimi i shkathhtësive verbale, numerike, zhvillimi fizik dhe socio-emocional dhe përgatitja për mësim janë të rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të fëmijëve. Pothuajse të gjithë fëmijët (e mostrës nacionale dhe atë të vendbanimeve rome) kanë zhvillim të drejtë në lidhje me zhvillimin fizik dhe përgatitjen për mësim, madje edhe në zhvillimin socio-emocional deri në një masë të konsiderueshme. Mirëpo shumë më i vogël është zhvillimi në drejtëm të përvetësimit të shkathhtësive verbale dhe numerike.




ARSIMI

FËMIJËT, TË CILËT JANË NË MOSHË PËR ARSIM FILLOR DHE SHKOJNË NË SHKOLLË FILLORE



FËMIJËT, TË CILËT MËSOJNË NË SHKOLLË TË MESME





Numrat tregojnë se më shumë se gjysma e të rinjve, të cilët janë në moshë për arsim të mesëm, nga vendbanimet rome nuk e ndjekin mësimin. Po ashtu është më i ulët probabiliteti i vajzave të vendbanimeve rome dhe vajzave shqiptarë në ndjekjen e mësimin të mesëm në raport me meshkujt e komunitetit të njëjtë.

E drejta e mbrojtjes nga dhuna, eksploatimi dhe abuzimi


DISIPLINIMI I FËMIJËVE

Numrat vërtetojnë se relativisht një përqindje e ulët e prindërve besojnë se në edukimin e fëmijëve nevojitet dënimi. Mirëpo në praktikë shumica prej tyre zbatojnë dënimin fizik si metodë disiplinimi.

PRINDËRIT, TË CILËT PAJTOHEN SE NEVOJITET DËNIM FIZIK NË EDUKIMIN E FËMIJËVE NGA MOSHA 2 DERI NË ATË 14 VJEÇARE




FËMIJË, QË PËSOJNË DËNIME FIZIKE




FËMIJËT E MOSHËS 2 DERI NË 14 VJEÇ, TË CILËT KANË PËSUAR AGRESION FIZIK OSE PSIKIK, SI METODË E DËNIMIT NË BAZË TË MOSHËS

ÇFARËDO QOFTË METODE E DHUNSHME E DISIPLINIMIT




PËRSHKRIMI: ■ Mostra nacionale ■ Vendbanimet rome

VAJZAT E MOSHËS 15-19 VJEÇARE, TË CILAT JANË TË MARTUARË OSE BASHKËJETOJNË



Kurorat e lidhura në moshë të mitur paraqesin shkelje të të drejtave të njeriut, me çka kanoset zhvillimi fizik dhe mendor i vajzave, gjë që shpeshherë rezultojnë me shtatzëni të hershme dhe izolim social. Numrat vërtetojnë se çdo vajzë e pestë e moshës 15-19 vjeçare është e kurorëzuar ose është në bashkëjetesë.

GRATË, TË CILAT BESOJNË SE ËSHTË E ARSYESHME QË BURRI TA RRAH GRUAN E VETË



Besimet kulturore se është e arsyeshme, që burri ta rrah gruan e vetë, duket se janë të ndërlidhura me proporcionin e ushtrimit të dhunës ndaj grave nga ana e burrave/partnerëve të tyre. Supozimi bazë në këtë pikë është se gruaja, e cila pajtohet me qëndrimin se është e arsyeshme, që burri/partneri ta rrah gruan e vetë në situata të caktuara, e njëjta do të pajtohet që edhe vetë të abuzohej nga burri i saj. Numrat vërtetojnë se ka më shumë mundësi, që gratë shqiptare, gratë e vendbanimeve rome dhe gratë, të cilat jetojnë në fshat ta arsyetojnë rrahjen e gruas nga burri, në proporcion me gratë e mostrës nacionale.

QASJA E GRAVE TË REJA NDAJ JETËS

GRATË E REJA, TË CILAT BESOJNË SE JETA E TYRE ËSHTË PËRMIRËSUAR NË VITIN E FUNDIT DHE PRESIN TË BËHET EDHE MË E MIRË

Kënaqësia nga jeta është masë e perceptimit personal për nivelin e mirëqenies personale. Numrat vërtetojnë se më shumë të reja e shohin të ardhmen me optimizëm.

